

PHILIPS

AVENT

SCF283, SCF282,
SCF281



Manuali i përdorimit

Përmbajtja

E rëndësishme	3
Hyrje.....	4
Përmbledhje e produktit	4
Përpara përdorimit të parë.....	5
Përgatitja për përdorim	7
Mbushja e koshit	7
Përdorimi i sterilizuesit në mikrovalë	11
Pastrimi	14
Garancia dhe servisi	14

E rëndësishme

Lexojeni me kujdes këtë manual përdorimi përpara se ta përdorni sterilizuesin për mikrovalë dhe ruajeni për referencë në të ardhmen.

Paralajmërim

- Lëreni sterilizuesin të ftohet përpara se ta hiqni nga mikrovala. Bëni kujdes kur e lëvizni apo hapni sterilizuesin, pasi uji brenda mund të jetë ende i nxehtë.
- Mos e hiqni menjëherë kapakun e sterilizuesit pas sterilizimit, pasi avulli që del mund të jetë shumë i nxehtë. Lëreni sterilizuesin të ftohet, pasi avulli mund të shkaktojë djegie.
- Përdorni vetëm ujë pa aditivë.
- Sigurohuni gjithnjë që bazamenti të jetë i mbushur me ujë kur ta përdorni sterilizuesin në mikrovalë.
- Mos futni zbardhues apo kimikate të tjera në sterilizues.
- Mos vendosni sende metalike në sterilizues, pasi mund të dëmtoni mikrovalën.
- Mos e mbingarkoni sterilizuesin, përndryshe sende brena nuk sterilizohen siç duhet.
- Sterilizoni vetëm biberonët e foshnjave dhe artikuj të tjerë të përshtatshëm për sterilizues. Kontrolloni manualin e përdorimit për sendet që dëshironi të sterilizoni, për t'u siguruar që janë të përshtatshëm për sterilizues.
- Ky sterilizues synohet vetëm për përdorim shtëpiak.

Kujdes


- Fëmijët duhen mbikëqyrur për t'u siguruar që të mos luajnë me sterilizuesin.
- Sigurohuni gjithnjë që bazamenti të mbushet me 200ml ujë përpara se të nisni sterilizimin.
- Pas çdo përdorimi, pasi të jetë ftohur derdheni ujin që mund të ketë mbetur nga sterilizuesi.
- Lëreni gjithnjë sterilizuesin të ftohet përpara se ta vendosni për ruajtje diku.
- Lajini gjithnjë duart përpara se të prekni sendet e sterilizuara.

- Mos e ekspozoni sterilizuesin ndaj nxehtësisë ekstreme apo dritës së drejtpërdrejtë të diellit.
- Mos e vendosni sterilizuesin mbi sipërfaqe të nxehta.
- Nëse përdorni furrë të kombinuar (me funksion skare), sigurohuni që furra apo skara të jetë e fukur dhe të jetë ftohur përpara se të futni sterilizuesin në të.

Hyrje

Urime për blerjen dhe mirë se vini pranë Philips Avent! Për të përfutur plotësisht nga mbështetja që ofron "Philips Avent", regjistroni produktin në faqen **www.philips.com/welcome**.


Përmbledhje e produktit



Përpara përdorimit të parë

Përpara se ta përdorni sterilizuesin për herë të parë, pastrojeni mirë siç përshkruhet më poshtë.


- 1 Hiqeni koshin nga bazamenti.
- 2 Mbushni një shishe për foshnja ose një gotë matëse me saktësisht 200 ml ujë rubineti dhe hidheni atë në bazament.




Shënim

- Sasia e ujit duhet të jetë saktësisht 200 ml. Kur bazamenti përmban shumë ujë, artikujt nuk do të sterilizohen siç duhet. Kur bazamenti nuk përmban ujë të mjaftueshëm, kjo mund të dëmtojë sterilizuesin ose mikrovalën.


- 3 Vendosni koshin në bazament.



- 4 Vendosni kapakun në sterilizues (1) dhe shtyni poshtë kapëset për të kyçur kapakun në vend (2).



5 Vendosni sterilizuesin në mikrovalë.




Shënim

- Sigurohuni që mikrovala të jetë e pastër dhe e thatë përpara se të filloni sterilizimin.
- Nëse keni furrë të kombinuar, sigurohuni që furra apo skara të jetë e fukur dhe të jetë ftohur përpara se të futni sterilizuesin në të.

6 Zgjidhni fuqinë dhe kohën e duhur të mikrovalës (shihni tabelën në kapitullin "Përdorimi i sterilizuesit me mikrovalë") dhe lëreni mikrovalën të punojë.

7 Pasi mikrovala të ketë mbaruar, hapeni atë dhe lëreni sterilizuesin të ftohet përpara se ta hiqni nga mikrovala.

8 Hapni kapëset (1) dhe hiqni kapakun (2).



9 Derdheni ujin e mbetur dhe shpëlajeni bazamentin dhe koshin plotësisht.

Përgatitja për përdorim

Mbushja e koshit

Përpara se t'i vendosni artikujt për sterilizim në kosh, pastrojini mirë në enëlarëse ose me dorë me ujë të ngrohtë dhe me pak detergjent enësh. Sigurohuni që të hiqni të gjitha mbetjet e qumështit.




Shënim

- Sigurohuni që të gjithë artikujt për sterilizim të çmontohen plotësisht dhe të vendosen në kosh me pjesët e hapur për poshtë, në mënyrë që të mos mbushen me ujë.
- Mos i stivoni artikujt shumë pranë njëri-tjetrit. Avulli duhet të jetë në gjendje të qarkullojë rreth artikujve për të siguruar sterilizim efektiv.


Ka disa mënyra për ta mbushur koshin:

Katër shishe "Philips AVENT"


1 Vendosini shishet përmbys në gropëzat e shisheve.



2 Vendosini biberonët në gropëzat e biberonëve.




3 Vendosini lirshëm unazat vidhosëse mbi biberonët.






- Unazat e mëdha vidhosëse përshtaten vetëm nëse vendosen në pozicion të pjerrët mbi biberonë.

4 Vendosni kapakët sferikë në mbajtëset e kapakëve sferikë.




Dy shishe të mëdha "Philips AVENT" (330 ml)


1 Vendosini buzët e shisheve në foletë për shishe të mëdha.



2 Vendosini biberonët në gropëzat e biberonëve.




3 Vendosini lirshëm unazat vidhosëse mbi biberonët.




- Unazat e mëdha vidhosëse përshtaten vetëm nëse vendosen në pozicion të pjerrët mbi biberonë.

4 Vendosni kapakët sferikë në mbajtëset e kapakëve sferikë.




Katër gota ruajtjeje dhe kapakë "Philips AVENT"

1 Vendosini gotat e ruajtjes përmbys në kosh.



2 Vendos kapakët vertikalisht rreth shisheve.




Dy pompa gjiri dhe dy shishe "Philips AVENT"


Shënim

- Mos i vendosni pjesët elektrike në sterilizues.


- 1 Çmontoni plotësisht pompën e gjirit.
- 2 Vendosini buzët e trupit të pompës në foletë e pompës së gjirit në pjesën e poshtme të koshit.



- 3 Vendosini shishet përmbys në gropëzat e shisheve.



- 4 Vendosini pjesët e mbetura joelektrike të pompës së gjirit në pjesët pa pengesa të koshit.



Shënim


- Sigurohuni që avulli të mund të qarkullojë rreth këtyre pjesëve.

Përdorimi i sterilizuesit në mikrovalë

Shënim

- Vendosni në sterilizues vetëm artikuj që janë të përshtatshëm për sterilizim. Mos e sterilizoni furçën e shishes ose artikujt që janë të mbushur me lëng, p.sh. kruajtëse dhëmbësh të mbushura me lëng ftohës.
- Pastrojini shishet dhe artikujt e tjerë përpara se t'i sterilizoni.


- 1** Hiqeni koshin nga bazamenti.
- 2** Mbushni një shishe për foshnja ose një gotë matëse me saktësisht 200 ml ujë rubineti dhe hidhjeni atë në bazament.



Shënim


- Sasia e ujit duhet të jetë saktësisht 200 ml. Kur bazamenti përmban shumë ujë, artikujt nuk do të sterilizohen siç duhet. Kur bazamenti nuk përmban ujë të mjaftueshëm, kjo mund të dëmtojë sterilizuesin ose mikrovalën.

- 3** Vendosni koshin në bazament.




- 4** Vendosni artikujt për sterilizim në kosh (shihni kapitullin "Përgatitja për përdorim").

- 5** Vendosni kapakun në sterilizues (1) dhe shtyni poshtë kapëset për të kyçur kapakun në vend (2).



- 6** Vendosni sterilizuesin në mikrovalë.



Shënim

- Sigurohuni që mikrovala të jetë e pastër dhe e thatë përpara se të filloni sterilizimin.

- 7** Zgjidhni Zgjidhni fuqinë dhe kohën e duhur të mikrovalës (shihni tabelën më poshtë) dhe lëreni mikrovalën të punojë.

Shënim

- Nëse keni furrë të kombinuar, sigurohuni që furra apo skara të jetë e fukur dhe të jetë ftohur përpara se të futni sterilizuesin në të.
- Mos e tejkaloni kohën e sterilizimit që tregohet në tabelë.

Specifikimet e mikrovalës

Fuqia	Koha e sterilizimit	Koha e ftohjes
1200 W- 1850 W	2 min	2 min
850 W- 1100 W	4 min	2 min
500 W - 800 W	6 min	2 min

8 Pasi mikrovala të ketë mbaruar, hapeni atë dhe lëreni sterilizuesin të ftohet përpara se ta hiqni nga mikrovala.

Shënim


- Bëni kujdes, pasi nga mikrovala mund të dalë avull i nxehtë.

9 Hiqni sterilizuesin nga mikrovala.

Shënim

- Sigurohuni që ta mbani sterilizuesin në një sipërfaqe të rrafshët për të shmangur rrjedhjen apo derdhjen e ujit të nxehtë.
- Artikujt e sterilizuar qëndrojnë sterilë për deri në 24 orë në sterilizuesin me mikrovalë nëse nuk e hiqni kapakun.

10 Hapni kapëset (1) dhe hiqni kapakun (2).



11 Hiqni shishet dhe artikujt e tjerë nga koshi. Përdorni mashat për heqjen e artikujve të vegjël.

Shënim

- Bëni kujdes, pasi nga sterilizuesi mund të dalë avull i nxehtë dhe artikujt e sterilizuar mund të jenë ende të nxehtë.

12 Pasi të keni hequr artikujt e sterilizuar, derdhni ujin e mbetur, shpëlani bazamentin dhe koshin plotësisht dhe thajini të gjitha pjesët duke i fshirë.

Pastrimi

Pastroni kapakun, koshin dhe bazamentin pas çdo përdorimi, për të parandaluar grumbullimin e çmërsit.

Shënim

- Mos përdorni asnjëherë sfungjerë gërvishtës, solucione gërryese pastrimi apo lëngje agresive si p.sh. zbardhues, vajguri apo aceton për të pastruar pajisjen.
- Shënim: Lëreni sterilizuesin të ftohet përpara se ta pastroni.

1 Pastrojini pjesët e sterilizuesit në ujë të nxehtë me pak detergjent enësh.

Shënim

- Pjesët e sterilizuesit mund t'i pastroni edhe në enëlarëse.

2 Pas pastrimit, thajini të gjitha pjesët siç duhet.

Shënim

- Pas pastrimit, ruajeni sterilizuesin në një vend të pastër dhe të thatë.

Garancia dhe servisi

Nëse keni nevojë për shërbim apo informacion ose nëse keni një problem, vizitoni faqen e internetit të "Philips" në **www.philips.com** ose kontaktoni me qendrën e kujdesit për klientin të "Philips" në shtetin tuaj (numrin e telefonit mund ta gjeni në fletëpalosjen e garancisë ndërkombëtare). Nëse nuk keni qendër shërbimi të klientit në shtetin tuaj, paraqituni pranë shitësit vendas të "Philips".



© 2022, Koninklijke Philips N.V.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

10/03/2022